



kji

Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo

Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute

Arsimim Ligjor për Drejtësi



*Ne nuk bëjmë
drejtësi*

*Ne e bëjmë
drejtësinë më të mirë*



Përmbajtja

- *Hyrje*
- *Misioni dhe Funkcionet e IGJK-së*
- *Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm*
- *Programi i Trajnimit Fillestar*
- *Provimi Përgatitor*
- *Programi i Trajnimit për Avancim*
- *Trajnimi i profesionistëve të tjerë në lëmin e gjyqësisë dhe prokurorisë*
- *Trajnimet për Trajnues*
- *Publikimet*
- *Struktura Organizative*
- *Vlerësime dhe komente nga pjesëmarrësit e trajnimeve*



Prishtinë, dhjetor 2012

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) për 12 vite të funksionimit të tij ka arritur një zhvillim të rëndësishëm në trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve, kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe profesionistëve të tjerë nga lëmi i gjyqësisë në vendin tonë.

Programet e ndryshme trajnuese të IGJK-së jo vetëm që mbulojnë të gjitha fushat e ligjit, por trajtojnë edhe aspekte të ndryshme jashtë jetës ligjore, me qëllim të ngritjes profesionale dhe forcimit të parimeve të pavarësisë, paanshmërisë dhe etikës profesionale, të përfituesve të IGJK-së.

Përkundër shumë sfidave, ndryshimeve ligjore dhe proceseve reformuese në sistemin gjyqësor e prokurorial të vendit, në bashkëpunim me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, IGJK ka arritur të zhvillojë me sukses programin e përgatitjes për katër gjenerata të kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë dhe ka zbatuar më tutje trajnimin e vazhdueshëm dhe trajnimin për avancim për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionist tjerë nga lëmi i gjyqësisë. Nuk ka dilemë se këto aktivitete, kanë kontribuar në konsolidimin e një sistemi profesional gjyqësor e prokurorial në Kosovë.

Ndihem krenar që në cilësi të Drejtorit të IGJK-së komunikojmë përmes kësaj fletushke e cila në një formë të përmbledhur, prezanton misionin, përmbushjen e funksioneve ligjore dhe të arriturat e IGJK-së.

Jemi të sigurt se shërbimet e IGJK-së do të mbështesin ndërtimin e një sistemi gjyqësor e prokurorial profesional i cili mbron të drejtat individuale, mirëqenien e përgjithshme dhe rrit besimin e qytetarëve në drejtësi.



Misioni i OSBE-së, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit themeloi sektorin për trajnime gjyqësore, i cili më vonë në shkurt të vitit 2000, u riemërua si Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Më 24 prill 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara miratoi Rregulloren 2006/23 për shpalljen e Ligjit për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Ky ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2006. Përmes këtij ligji IGJK u bë institucion i pavarur profesional dhe kryesor për aftësim profesional brenda sistemit gjyqësor të Kosovës i cili duhet t'i përmbush funksionet e veta bazuar në parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë dhe efikasitetit.



Foto 2. Trajnime të mbajtura në IGJK

Misioni i IGJK-së është, ofrimi i cilësisë më të lartë të trajnimeve me qëllim të ngritjes profesionale për gjyqtarë, prokurorë, kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë si për profesionist tjerë nga lëmi i gjyqësisë dhe prokurorisë në Kosovë. Ky mision realizohet duke shfrytëzuar teknikat më të avancuara të mësimdhënies për të rritur.

Përgjegjësitë kryesore të IGJK-së sipas Ligjit për themelimin e tij, janë;

- Trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Vlerësimi dhe organizimi i provimit përgatitor, për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Trajnimi fillestar i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Trajnimet e posaçme për avancim të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Trajnimet për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë;
- Trajnimet e profesionistëve të tjerë në lëmin gjyqësisë të identifikuar nga IGJK;
- Zhvillimi i planeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për një gjyqësi efikase, efektive dhe të paanshme;
- Veprimtaritë tjera profesionale si institucion profesional-kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV) është program trajnimi i cili iu dedikohet gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

PTV hartohet duke përdorur teknika, mekanizma dhe metodologji të veçanta të cilat mundësojnë një program gjithëpërfshirës dhe të llojllojshëm.

Pas hartimit, drafti i PTV diskutohet nga Këshilli Programor dhe në fund miratohet nga Këshilli Drejtues i IGJK-së.

Qëllimi kryesor i PTV është zhvillimi dhe avancimi i shkathtësive profesionale praktike dhe ekspertizës ligjore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.


PTV përmban për trajtim çështje nga:

- E drejta penale (materiale, procedurale dhe ekzekutimi i sanksioneve penale);
- Drejtësia për të mitur;
- E drejta civile me të gjitha ndarjet e fushës;
- E drejta administrative;
- E drejta evropiane dhe ndërkombëtare;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e sajë;
- Lëmia e kundërvajtjeve;
- Programe trajnimi të veçanta si: etikë, menaxhim i rasteve, komunikim, zhvillim të shkathtësive të përfaqësimit gjatë gjyqimit, gjuhë të huaja, shkrim dhe arsyetim ligjor, etj).


IGJK ka filluar zbatimin e trajnimeve të PTV edhe përmes platformës së mësimin në distancë (e-learning).

Në disa trajnime të PTV (sipas temave të karakterit më të specializuar) marrin pjesë edhe zyrtarë të institucioneve dhe shërbimeve që lidhen me gjyqësorin.

Trajnimet e realizuara në PTV 2000 - 2012



Trajnimet e realizuara në PTA & PTV gjatë vitit 2012



**Në këtë grafik prej vitit 2010 janë paraqitur trajnimet e realizuara për gjyqtarë e prokurorët në të dy programet trajnuese PTV dhe PTA, pasi që përfituesit kanë qenë gjyqtarë e prokurorë dhe organizmi i trajnimeve në njërin program ka pasur efekt tek programi tjetër.*

Programi i Trajnimit Fillestar (PTF) është program trajnimi i cili iu dedikohet kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm.

PTF është i ndarë në tri faza.

- Faza e parë zgjatë 6 muaj. Në këtë periudhë kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë trajnohen së bashku;
- Faza e dytë zgjatë 3 muaj. Në këtë fazë trajnohen ndaras kandidatët për gjyqtarë nga ata për prokurorë;
- Faza e tretë zgjatë 6 muaj. Në këtë periudhë kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë caktohen në gjykata dhe prokurori, ku ushtrojnë punë praktike nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre (gjyqtarë/prokurorë).


Realizimi i PTF deri më tani është bërë bazuar në 34 module (programe trajnuese), ndërsa në fund të trajnimeve për secilin modul kandidatët i nënshtrohen provimeve.

Numri i kandidatëve në PTF, përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Në bazë të Ligjit për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, IGJK është përgjegjëse për organizimin dhe vlerësimin e Provimit Përgatitor për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë.

Provimi përgatitor është parakusht për fillimin e trajnimeve në PTF dhe vetëm kandidatët me rezultatet më të larta në këtë provim e fitojnë të drejtën për të ndjekur trajnimet e PTF. Përbërja e Komisionit për hartimin dhe vlerësimin e provimit miratohet nga Këshilli Drejtues i IGJK-së.




Në bazë të ligjit dhe statutit të IGJK-së, PTA organizohet për:

- gjyqtarë dhe prokurorë të posa emëruar të cilët më parë nuk kanë punuar në pozita të tilla, dhe
- gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës vendosë t'i avancojë në nivele të ndryshme;

Qëllimi kryesor i PTA është që të mbështes ngritjen e aftësive dhe shkathtësive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar dhe atyre që kanë ndërruar funksionet e tyre.

Trajnimet e realizuara në PTA 2010 -2012




8

Trajnimi i profesionistëve të tjerë në lëmin e gjyqësisë dhe prokurorisë

IGJK përveç trajnimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka përgjegjësi ligjore që të identifikojë dhe trajnojë edhe profesionistë të tjerë në lëmin e gjyqësisë dhe prokurorisë.

Gjatë vitit 2012 janë realizuar 10 aktivitete trajnuese ku përfitues kanë qenë bashkëpunëtorët profesional të gjykatave dhe prokurorive, zyrtarët përmbarues të gjykatave dhe gjyqtarët porotë.

Trajnimet e realizuara për gjyqtarë porotë dhe profesionist të tjerë në fushën e gjyqësisë 2005-2012




IGJK, në vazhdimësi është e përkushtuar në ngritjen e metodave më të avancuara të trajnimit.

Që nga viti 2004, ky program është mjaft aktiv dhe në kuadër të tij janë organizuar trajnime për trajnuesit që marrin pjesë në hartimin dhe realizimin e programeve të IGJK-së.



Këto trajnime kryesisht janë organizuar në mbështetje nga partnerë të IGJK-së.




Trajnimet e realizuara në TOT 2004 -2012



IGJK-ja realizon një seri të publikimeve (revista, buletin, doracak, module trajnuese, udhëzues) përmes të cilave synohet mbështetja profesionale për gjyqtarët, prokurorët, kandidatët për këto pozita dhe profesionistët tjerë të gjyqësisë e prokurorisë. Përmes këtyre publikimeve pasqyrohet edhe përmbajtja e aktiviteteve të Institutit si dhe prezantohen aspekte të ndryshme profesionale për tema të llojllojshme.





Trajnimet janë shumë të dobishme në thellimin e njohurive të nevojshme

Metoda e qasjes praktike të mësimit të avancuar është metodë e dobishme për të ardhmen

IGJK të vazhdoj organizimin e trajnimeve në nivel regional me përfshirje më të madhe të gjyqtarëve, dhe të ketë lloje të seminareve për interpretim të ligjeve.

Të organizohen seminare të tilla me qëllim që të kemi një kuadër të mirë profesional

Trajnime lidhur me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut të mbahen më shpesh sepse për një pjesë të gjyqtarëve janë më pak të njohura e për këto njohuri kemi nevojë

**Instituti Gjyqësor i Kosovës
Prishtinë**

Tel: +381 38 200 18 660

+381 38 200 18 667

+381 38 200 18 679

Fax: +381 38 200 18 529

Web: <http://igjk.rks.gov.net>

E-mail: infokji@rks.gov.net

Kosovo Judicial Institute (KJI)